



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____prot.

Shkodër, me _____.____. 2024

Pershendetje!

Ne lidhje me informacionin qe kerkoni sa i perket ecurise se punimeve te rruges Shengjin - Velipoje, lejes se ndertimit apo edhe informacione te jera, ju sugjerojme te drejtoheni me kerkese FSHZH duke qene se jane investitoret e ketij objekti.

Nderkohe, bashkia Shkoder ka permbushur detyrat e saja funksionale persa i perket :

1.Procedures se shpronese publike ku me pergatitjen e dokumentacionit perkates ,i eshte drejtuar me shkrese ASHSH (Agjencia Shtetore e Shproneseve),me objekt “Kerkese per shpronese publik” , ne zbatim te nenit 10 të ligjit 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private me interes publik“i ndryshuar ,dhe ne mbeshtetje te Vendimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit Nr. 11, datë 26.01.2021 “Për miratimin e lejes së ndërtimit të Infrastrukturës: “Ndërtimi I rrugës Shëngjin – Velipojë, Lot 1, Faza I”

Ne vijim te procedures ASHSH (Agjencia Shtetore e Shproneseve) ka derguar per miratim Keshillit te Ministrave kerkesesh e bashkise Shkoder , ku me VKM nr.246 datë 20.04.2023 “SHPRONESIM , PER INTERES PUBLIK ,TE PRONAVE TE PASURIVE TE PALUAJTSHME,PRONE PRIVATE , QE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDERTIM I RRUGES SHENGJIN –BAKS-RRJOLL-LOTI1,FAZA1” ka miratuar listen e pronareve te cilet shproneseohen per interes publik ne funksion te projektit “ “Ndërtimi I rrugës Shëngjin – Velipojë, Lot 1, Faza I” .

Sipas pikes 7 te ketij Vendimi duhet thene se te gjithe individet/subjektet te cilat jane prekur nga ky investim duhet te dorezojne dokumentacionin e nevojshem per likuidim prane ASHSH.

Nga sa me siper qytetaret jane informuar me shkrese nr.6039 date 28.04.2023 per proceduren e dorezimit te dokumentacionit per likujdimi.

Bashkangjitur VKM 246 date 20.04.2023 , shkresa nr.6039 prot , date 28.04.2023.

Duke ju falemnderuar

Benet BECI

KRYETAR



ILNDRIM, UDHEZIM, SHKRESA, KERKES/
NR. 5702 DATE 25.4.23
BERGUAR NGA:
LENDË:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PARRODIA E TITULLARIT:

V E N D I M

Nr. 246, datë 20.4.2023

P Ë R

**SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN
NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I RRUGËS SHËNGJIN –
BAKS – RRJOLL – VELIPOJË, LOTI 1, FAZA 1”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës Shëngjin – Baks – Rrjoll – Velipojë, loti 1, faza 1”.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “truall” dhe “pyll”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi, prej 9 337 698.25 (nëntë milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë njëzet e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 337 698.25 (nëntë milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë njëzet e pesë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria "Fondi i shpronësimeve" në Bankën e Shqipërisë.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Shkodër.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare" dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.
8. Bashkia Shkodër kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Shkodër.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
12. Për pasurinë me numër rendor 5, në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për likuidimin e vlerës së shpronësimit, zbatohen parashikimet në nenin 16, pika 2, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", të ndryshuar.
13. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Shkodër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, Agjencia

Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

BELINDA BALLUKU

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK,
"NDËRTIMI I RRUGËS SHËNGJIN-BAKS-RJOLL-YELLIPOJË LOT 1, FAZ 1".**

Nr. Rendor	TË DHËNAT E PRONËSISË				TË DHËNA KADASTRALE (SI PAS KARTELËS SË PASURISË)							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM			VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (kufizime hipotekore, barrë mbi pasuritë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Z. Kadastrale	Indeksi i hartes	Nr. Pasurise	Lloji i pasurise	Siperfaqja totale (m ²)	Volumi	Faqe	Siperfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)		
1	Kol	Ndue	Fusha	Shkoder	1076	K-34-75(112-D)	49/1	are + truall	1500	1	52	180	4,452.90	801,522.36	Konfirmuar nga ASHK	
2	Pashko	Fran	Syll	Shkoder	1076	K-34-75(112-C)	21	are	2500	1	21	272	4,452.90	1,211,189.34	Konfirmuar nga ASHK	
3	Pal	Fran	Syll	Shkoder	1076	K-34-75(112-C)	22	are	2000	1	22	414	4,452.90	1,843,501.43	Konfirmuar nga ASHK	
4	Mark	Fran	Syll	Shkoder	1076	K-34-75(112-C)	20/1	are	2500	1	20	478.5	4,452.90	2,130,713.61	Konfirmuar nga ASHK	
4	Rake	Kole	Molla (Matolaj)	Shkoder	1076	K-34-75(112-C)	175	are	3400	1	195	577	4,452.90	2,569,323.30	Konfirmuar nga ASHK	
	Vere	Kole	Molla (Hotaj)													
	Flora	Kole	Molla (Dushi)													
	Violeta	Kole	Molla													
	Luledzim	Kole	Molla (Vukساني)													
Fatbardhe	Kole	Molla (Mikelaj)														
5	Gani		Bokrina	Shkoder	1076	K-34-75(112-D)	116/13	pyll	34500	3	159	347	2,136.52	741,372.09	741,372.09	Konfirmuar nga ASHK Per pasurine ka proces gjyqesor me objekt "Falsifikim dokumentacioni" Ref 0268. Pasuri e Riverzuar Ref 0261. Pasuria kufizohet me vendim Gjyqate, Pasurise i vendoset sekuestro preventive n:6248 date 25.01.2022.
6	Ismet	Ymer	Balaj	Shkoder	1076	K-34-75(112-D)	56/3	are	650	3	174	9	4,452.90	40,076.12	40,076.12	Konfirmuar nga ASHK
Vlera e shpronësimit																
													2277.5	9,337,698.25	9,337,698.25	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 6038 prot

Shkodër, 28.4.2023

Lënda : Njoftim.

Z.Kol Ndue Fusha

Baks-Rrjoll , Njesia Administrative Velipoje

Z.Pashko Fran Zyli

Baks-Rrjoll , Njesia Administrative Velipoje

Z.Pal Fran Syli

Baks-Rrjoll , Njesia Administrative Velipoje

Z.Mark Fran Syli

Baks-Rrjoll , Njesia Administrative Velipoje

Zj. Rake Kole Molla (Malotaj)

Zj. Vere Kole Molla (Hotaj)

Zj.Flora Kole Molla (Dushi)

Zj.Violete Kole Molla

Z. Lulezim Kole Molla

Z. Fatbardhe Kole Molla (Vuksani)

Zj.Flutur Kole Molla (Mikelaj)

Baks-Rrjoll , Njesia Administrative Velipoje

Z.Gani Bokrina

Baks-Rrjoll , Njesia Administrative Velipoje

Z.Ismet Ymer Balaj

Baks-Rrjoll , Njesia Administrative Velipoje

Për dijëni: NJESIA ADMINISTRATIVE VELIPOJE
VELIPOJE , Njesia Administrative Velipoje

Për dijëni: MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCISË SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN
Adresë: Rruga "Abdi Toptani" nr.1, Tiranë.

Për dijëni: FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
Rr.Sami Frashëri , TIRANE

Bashkia Shkodër në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendrore" , VKM-së numër 246 datë 20.04.2023 me objekt " SHPRONESIM, PER INTERES PUBLIK, TE PRONAREVE TE PASURIVE TE PALUAJTSHME , PRONE PRIVATE , QE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDERTIMI I RRUGES SHENGJIN –BAKS-RRJOLL-VELIPOJE,

LOTII,FAZAI" (protokolluar pranë Bashkisë Shkodër me nr. 5702 prot , datë 25.04.2023), pikes 7 të këtij vendimi , ju njofton se duhet të paraqiteni pranë Agjencisë Shtetërore të Shpronësimeve , MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE për dorëzimin e dokumentacionit ligjor për përfundimin e procedurave të likujdimit financiar.

Bashkangjitur VKM Nr.246 date 20.04.2023.

Duke ju falenderuar !

KRYETAR

Bardh SPAHIA

ME VENDIM DELEGIMI

Z/ KRYETAR

Tonin DED

